

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLOGOC
GLOGOC MUNICIPALITY

PRANUAR	07.07	20	23
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
	05-400/01	-32799	



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

DATË/A:	07.07.2023
REFERENC-Ë:	///
PËR/ZA/TO:	Bizneset e Komunës së Drenasit
CC:	Zyrës së Kryetarit të Komunës së Glogoc, Z. Ramiz Lladrovci
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Drejtori. Znj Agnesë Kastrati Bucolli
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Thirrje për Aplikim



THIRRJE PER APLIKIM

Bazuar në rregulloren komunale për ndarjen e subvencioneve nr: 02-400/01-18380. të datës 27-04-2022, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik (DZHE) në Komunen e Drenasit, në kuader të programit "Participimi tek Ndërmarrjet mikro (0-9 punëtor) dhe Start Up" shpallë konkurs për mbështetje financiare duke iu dhënë prioritet më shumë ,zeje tradicionale ,biznesëve inovative dhe start up , ideve në fushën e turizmit, ideve që ofrojnë me shumë punësim. Vlera e financimit do të jetë nga përgjiedhja e përfituesit, që bëhet në menyre konkurruese. Shuma maksimale e përfitimit është **2,000.00€** dhe përcaktohet nga plotësimi i kriterëve të shënuara më poshtë:

1. KRITERET E FINANCIMIT:

- Të jenë biznese që operojnë në komunën e Drenasit, ku edhe duhet të bëhet investimi.
- Në rast se është start up, regjistrimi i biznesit bëhet pas vlerësimit preliminar nga komisioni.
- Bizneset duhet të jenë të regjistruara në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK) në Komunen e Drenasit.
- Të gjeneroj punësim me marrjen e grantit. Biznesi duhet të punësoj së paku një punonjës me marrjen e grantit. Punësimi i më tepër se një punonjësi për biznesin konsiderohet përparësi.
- Bizneset duhet të dëshmojnë se janë funksionale, të qëndrueshme në treg dhe kanë kapacitet të mjaftueshëm për zgjerimin e prodhimit, qarkullimit dhe rritjen e numrit të punonjësve. Ketë e dëshmojnë përmes formularit në ATK "Gjendja e Pergjithëshme e Qarkullimit"

- Bizneset të cilat promovojnë ide kreative dhe inovative në tregun tonë do të kenë përparësi.
- Bizneset duhet të dëshmojnë se kanë kujdes të duhur në ruajtje të ambientit nga ndotja e mundëshme prej operimit të biznesit të tyre. Për këte bizneset duhet të posedojnë Pelqimin Sanitar nga Komuna dhe Licencën nga Ministria përkatëse e linjës (nëse është e aplikueshme).
- Përparësi kanë bizneset që udhëhiqen nga gratë, të rinjtë nën moshën 40 vjeqare dhe bizneset në fushën e artizanateve.
- Plani i investimit duhet të specifikohet mirë, kështu që në momentin e aplikimit biznesi duhet të sjellë profaturën për paisjen/paisjet, sipas planit të Investimit.
- Bizneset duhet të kontribuojnë me vetëfinancim, më së paku më 20% të vlerës së grantit të fituar, varësisht nga vlera e grantit të fituar.
- Bizneset duhet të dëshmojnë se i kanë të paguara obligimet ndaj komunës përkatëse dhe ATK-së.

SHUMA E PERFITUAR: Vlera maksimale e përfitimit është 2000.00 € dhe varet prej idesë së biznesit, kapacitetit të qarkullimit të cilën bizneset e dëshmojnë përmes formularit të ATK-së "Gjendja e Përgjithshme e Qarkullimit", prej numrit të të punësuarve, veprimtarisë dhe vizitës në terren. Vlerësimi i dokumentacionit dhe i biznesit të aplikueseve për grante, bëhet nga Komisioni Vlerësues.

FORMA E PAGESES: Nëse zgjidheni përfitues, nënshkruhet Kontrata me Komunen/DZHE, përfituesi duhet të prezentoj faturën me të cilën dëshmohet blerja e pajisjes/ve, së bashku dëshminë e transferit bankar nga xhironlogaria e biznesit tuaj tek operatori ekonomik (shitësi), si dhe verifikimi në teren nga ana e zyrtarëve kompetent. Komuna e bënë rimbursimin e mjeteve financiare në vlerë të grantit.

2. KRITERET JO KUALIFIKUESE:

Biznesi nuk kualifikohet nëse:

1. Paraqet veti diskriminuese apo ka ndikim negativ në shoqëri dhe komunitet
2. I shkakton dëme ambientit apo ndonjë grupi tjetër të marginalizuar
3. Ka qenë përfitues nga DZHE në thirrjen e fundit.
4. Ka orientime apo qëllime politike
5. Kërkon mjete për të blerë tokën për ndërtim të objektit
6. Merret vetëm me tregtimin e produkteve
7. OJQ-te nuk kanë të drejtë të aplikojnë
8. Keni bërë ndryshim në biznes pas datës së shpalljes publike për Aplikim.

3. SI TE APLIKOHET?

Aplikacioni merret direkt në zyrën e DZHE, ose në web faqen e Komunës së Drenasit. Aplikacioni i shkarkuar plotësohet (forma elektronike ose me dorëshkrim), të cilën së bashku me dokumentacionin mbështetës që kërkohet më poshtë, e dorëzoni në arkiven komunale (kati i parë) .

4. **AFATI I APLIKIMIT:** Afati i aplikimit është nga data e shpalljes deri 28 Korrik 2023 (ora 16:00). Pas ketij afati, aplikacionet nuk pranohen.
5. **FAZA E PARË E E KUALIFIKIMIT:** Nëse kaloni fazën e parë të selektimit, në bazë të dokumentacionit të prezantuar, atëherë do të kontaktoheni nga zyrtarët komunal DZHE për hapat e mëtutjeshëm.

Për të aplikuar me dokumentacion komplet, nevojiten këto dokumente:

Bizneset Ekzistuese:

- Aplikacioni i plotësuar
- Çertifikata e biznesit (Për bizneset egzistuese, taksën në biznes), me informatat shtesë me kode të veprimtarive.
- Vertetimin nga ATK, që keni të punësuar së paku nje punonjës ne biznesin tuaj.
- Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (Bizneset egzistuese).
- Gjendja e përgjithshme nga ATK për periudhen tre mujore te fundit 2023.
- Pro faturen e rregullt me te gjitha shënimet e duhura si: numri i regjistrimit të biznesit, numri i pro faturës, emri i plotë i furnitorit (shitësit), adresa e saktë , nënshkrimi dhe vula e shitësit, dhe të gjitha të dhënat tjera të rëndësishme për furnitorin ku do të blihet pajisja/et, specifikacionin dhe fotot e pajisjeve apo mjeteve të punës me qmimin kushtues. (pro fatura sjellet në fazen e aplikimit)
- Vertetimin që nuk keni obligime (borxhe) tatimin në pronë.
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikusit (Biznesit)

Start up bizneset:

- Aplikacioni i plotësuar
- Kopja e leternjoftimit
- Pelqimin sanitar nga drejtoria e inspeksionit dhe Licenca nga ministria e përkatëse e linjës (mund të kerkohet nga komisioni, nese konsiderohet e nevojshme, gjatë vlerësimit)
- Pro faturen e rregullt me te gjitha shënimet e duhura si: numri i regjistrimit të biznesit, numri i pro faturës, emri i plotë i furnitorit (shitësit), adresa e saktë , nënshkrimi dhe vula e shitësit, dhe të gjitha të dhënat tjera të rëndësishme për furnitorin ku do të blihet pajisja/et, specifikacionin dhe fotot e pajisjeve apo mjeteve të punës me qmimin kushtues. (pro fatura sjellet në fazen e aplikimit)
- Vertetimin nga Gjykata se nuk është nën hetime

Verejtje: Aplikuesit qe nuk kanë biznese të regjistruara, nëse shpallen përfitues preliminar duhet te regjistrojnë bizneset e tyre dhe të hapin xhirollogaritë e biznesit, para se të shpallen përfitues final.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik



FORMA E APLIKACIONIT PËR PERKRAHJE FINANCIARE – 2023

ANEKSI: A

I. INFORMATAT E PËRGJITHSHME TË APLIKANTIT	
1. Emri dhe Mbiemri:	
2. Datëlindja:	
3. Gjinia:	<input type="checkbox"/> Femër <input type="checkbox"/> Mashkull
4. Numri personal:	
5. Vendbanimi:	
6. Profesioni:	
7. Numri telefonit:	
8. E-mail adresa:	
II. INFORMATAT E PËRGJITHSHME TË BIZNESIT	
Posedoni biznes	Po/Jo
10. Emri i Biznesit:	
11. Numri unik i regjistrimit:	Nr. Regjistrimit: _____
12. Statusi Legal i Biznesit:	<input type="checkbox"/> Biznes Individual <input type="checkbox"/> SHPK <input type="checkbox"/> tjetër _____

13. Pronari (ët), Përfaqësuesi (t) ligjor:	
14. Adresa e Biznesit:	
15. Personi i Autorizuar ligjor:	
16. Emri i Bankës, Xhirrollogaria e Biznesit:	

III. PËRSHKRIMI I SHKURTËR I PROJEKTIT/PLANIT TË BIZNESIT

17. Përshkruani gjendjen e tanishme të Biznesit tuaj :

18. Përshkruani idenë e Projektit/Planin e Biznesit Tuaj :

19. Çka planifikoni të prodhoni apo të përpunoni, çfarë shërbimesh do të ofroni:

Llojet e produkteve dhe shërbimeve që bëni:
1.
2.
3.
4.
5.

PËRFITUESIT Numri i të punësuarëve si rezultat i Grantit:
1.
2.

REZULTATET E PRITSHME NGA GRANTI: Çfarë pritni të realizoni me mjetet financiare nga GRANTI?
1.
2.
3.

20. Zhvillimi Biznesit tuaj: KLIENTET E BIZNESIT Kush janë klientët tuaj?
1.
2.

Plani Marketingut Ku dhe Si do t'i promovoni prodhimet/produktet apo shërbimet e juaja?
1.

2.

21. Përshkruani strukturën organizative të biznesit tuaj:	
Punonjës me orar të plotë / nëse keni sa janë?	
Punonjës me kohë të pjesëshme/ nëse keni sa janë?	
Praktikantët - Punonjësit e rinjë/ nëse keni sa janë?	

22. A jeni përfitues nga skema e Granteve Komunale paraprake gjatë vitit të kaluar nga DZHE?
<input type="checkbox"/> PO <input type="checkbox"/> JO

23. A keni marrë ndonjë fond nga burime/organizata tjera?	<input type="checkbox"/> PO <input type="checkbox"/> JO
Nëse PO ju lutem plotësoni te dhënat e mëposhtme	
Emri i Donatorit	
Shuma e përfituar në Euro	
Viti përfitimit të fondit	

24. Pajisjet, makineria, mjetet e punës të kërkuara përmes këtij projekti:				
Emri i pajisjes, mjetit të punës	SPECIFIKACIONI (Modeli, lloji, furnizuesi, karakteristikat teknike, viti i prodhimit, etj.)	Çmimi për njësi	Sasia kërkuar	Vlera totale EURO

Vlera totale e projektit:				

Burimet Financiare:	Shuma (€)	%
Kontributi personal		
Granti Komunal		
Kredi Bankare		
Tjera (specifiko)		
Shuma Totale		

Vërejtje: Në tabelat e mësipërme, mund të shtohet numri i kolonave sipas nevojës

DEKLARATË

Unë _____ deklaroj se informacionet e paraqitura në këtë kërkesë janë të plota, të besueshme dhe të vërteta, si dhe të mbështetura nga dokumentet përkatëse adekuate të cilat mund të verifikohen.

Po ashtu, unë DEKLAROJ se do të participoj sipas thirrjes publike.

Nënshkrimi:

(Emri, Mbiemri dhe Nënshkrimi)

Datë:
